

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) në datën 2 qershor 2016 nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi mbi “*Bashkëpunimin dhe Ndërveprimin Ndërinstitucional*”.

Kjo marrëveshje ka për qëllim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) në fusha me interes të përbashkët, nëpërmjet bashkërendimit të aktiviteteve midis dy institucioneve si dhe shkëmbimit të të dhënave bazuar mbi parimin e reciprocitetit.



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Znj. Pranvera Strakosha shprehu kënaqësinë për këtë bashkëpunim midis dy institucioneve, duke e cilësuar atë si të një rëndësie të veçantë. Ndër të tjera ajo bëri një prezantim të shkurtër të misionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke përmendur edhe problemet e hasura nga mosrespektimi i ligjit për nëpunësit civil. Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh, Komisionerja theksoi se pavarësisht burimeve të kufizuara njerëzore, stafi i Komisionerit është i gatshëm të ofrojë ekspertizën e tij në funksion të kësaj marrëveshje, duke u bazuar në parimin e transparencës dhe të ligjshmërisë. Në të njëjtën kohë, Znj. Strakosha shprehu vlerësimin për punën e bërë nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit duke theksuar se në disa raste, raportet e këtij institucioni kanë shërbyer si pikënisje për realizimin e mbikëqyrjeve dhe inspektimeve në institucione të ndryshme.

Në përfundim të takimit, Znj. Strakosha u shpreh se institucioni i cili përfaqëson është i hapur për bashkëpunime të mëtejshme, realizime të trajnimeve, tryezave të rumbullakta, seminareve etj.



Nga ana e tij, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Z. Bujar Leskaj e vlerësoi mundësinë e nënshkrimit të kësaj marrëveshje nga të dyja institucionet duke u angazhuar në realizimin e një bashkëpunimi sa më të frytshëm. Z. Leskaj u shpreh se bashkëpunimet midis institucioneve të pavarura krijojnë mundësi për një funksionim eficient të veprimtarisë së tyre, si dhe garantim të respektimit të ligjit. Ashtu si Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Kontrolli i Lartë i Shtetit merr përsipër të kontribuojë me shërbimet e ekspertizës, asistencës teknike dhe respektimit të kompetencave të Komisionerit për çështje

që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e shërbimit civil.

Z. Leskaj shprehu gjithë vullnetin e tij dhe të institucionit që përfaqëson për të shkëmbyer eksperiencat midis dy institucioneve dhe për të mundësuar falë këtij bashkëpunimi, përmbushjen e misionit të dy institucioneve.